

20111342963

L I G J

PËR NGARKIM ME BORXH TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS SIPAS MARRËVESHJES KORNIZË PËR HUA PËR FINANCIMIN E PJESSHËM TË PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E SALLAVE TË FIZKULTURËS NË SHKOLLA FILLORE DHE REHABILITIMIN E SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës me hua në shumë prej 30 000 000 eurosh, për financimin e pjesshëm të Projektit për ndërtimin e sallave të fizkulturës në shkolla fillore dhe rehabilitimin e shkollave fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen kornizë për hua për financimin e pjesshëm të Projektit për ndërtimin e sallave të fizkulturës në shkolla fillore dhe rehabilitimin e shkollave fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen kornizë për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Huaja nga neni 1 i këtij ligji do të tërhiqet së paku në dy transhe.

Afati i pagesës së çdo transheje të huas nga neni 1 i këtij ligji është më së shumti 20 vjet, me përfshirje të grejs periudhës deri në pesë vjet.

Transheja e parë duhet të tërhiqet në afat prej 12 muajsh nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 të këtij ligji dhe nuk duhet të tejkalojë 30% nga shuma e përgjithshme e huas.

Tërheqja e çdo transheje vijuese do të realizohet pasi që Republika e Maqedonisë me shkrim do ta njoftojë Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës se 90% nga shuma e transhesë paraprake është alokuar.

Neni 4

Shkalla kamatare do të rregullohet për çdo transhe të huas veç e veç, në ditën e dorëzimit të kërkesës për tërheqje të mjeteve të huas nga Ministria e Financave, varësisht nga ajo se cila shkallë kamatare është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse ose variable).

Neni 5

Projektin për ndërtimin e sallave të fizkulturës në shkolla fillore dhe rehabilitimin e shkollave fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë nga Marrëveshja kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 të këtij ligji, do ta realizojë Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 6

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.